



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI

Sesioni Pranveror

Komisioni për Integritet Evropian

Mbledhja nr. 25.

Prishtinë, më 02.10.2018 në ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRIME EVROPIANE

Në mbledhje morën pjesë: Blerta Deliu Kodra, Armend Zemaj, Fikrim Damka, Ismajl Kurteshi, Fatmire Kollçaku, Ilir Deda, Zenun Pajaziti, Donika-Kadaj-Bujupi, Visar Ymeri dhe Adem Hoxha.

Mungoj: Milaim Zeka

Nga Staffi Mbështetës i Komisionit:, Ahtere Loxha, Adelina Demolli, Safet Beqiri dhe Florent Mehmeti.

Pjesëmarrësit tjerë: Përfaqësuesi nga GIZ, OSBE-së, NDI, KDI, Zyra e BE-së dhe mediat.

Mbledhjen e kryesoi Blerta Deliu Kodra –Kryetare e Komisionit

Kryetarja pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë e hapi mbledhjen e Komisionit me këtë;

Rend Dite

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 19.09.2018;**
- 3. Miratimi i Planit të punës së Komisionit për sesionin vjeshtor 2018;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-103 për Ratifikimin e Ndryshimit dhe Plotësimit Nr.1 të Marrëveshjes Financiare për IPA 2015 ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian;**
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes Bilaterale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatit të**

Madh të Luksemburgut në Kuadër të Projektit të Bashkëpunimit Zhvillimor, KSV/019: Asistencë Teknike në Kontekst të Integritimit Evropian;

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-043 për lirin e asociimit në Organizata Joqeveritare, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

7. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua i pa ndryshuar

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 19.09.2018;

Procesverbali u miratua me vërejtje te deputetëve , Ismajl Kurteshi dhe Armend Zemaj.

3. Miratimi i Planit të punës së Komisionit për sesionin vjeshtor 2018;

Kryetarja tha se draft planin e punës së Komisionit që e keni para jush është për muajt e mbetur të këtij sesioni, ne si Komision per Integritime e kemi mbajtur dje një takim pune dhe propozimet që kanë dalë nga takimi i djeshëm janë inkorporuar ku është paraparë plotësimi i planit per muajt, tetor, nëntor dhe dhjetorë.

Andaj hap diskutimin dhe e hodhi ne votim miratimin e Planit të Punës .

Pasi nuk kishte vërejtje dhe propozime tjera konstatoj se një zëri nxori këtë :

Përfundim

U miratua Plani i Punës së Komisionit për sesionin vjeshtor 2018.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-103 për Ratifikimin e Ndryshimit dhe Plotësimit Nr.1 të Marrëveshjes Financiare për IPA 2015 ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian;

Kryetarja tha e kemi për shqyrtim projektligjin për ratifikimin e Ndryshimit dhe plotësimit Nr.1 të Marrëveshjes Financiare IPA 2015, ndryshim ky i cili është kërkuar që të bëhet me qëllim që të kalohet nga projekti i binjakëzimit në grant për Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Lidhur me këtë projektligj propozoj një amendament

Në titullin e projektligjit para fjalës “**Kosovës**” të shtohet fjala “**Republikës së**” dhe ky ndryshim vlen për tërë tekstin e projektligjit.

Hap diskutimin dhe e hudhi ne votim Projektligjin.

Pas votimit Kryetarja konstatoj se me shumicë votash Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

Miratohet Projektligji nr. 06/L-103 për Ratifikimin e Ndryshimit dhe Plotësimit Nr.1 të Marrëveshjes Financiare për IPA 2015 ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian me amendamentin e propozuar.

5. Shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes Bilaterale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatit të Madh të Luksemburgut në Kuadër të Projektit të Bashkëpunimit Zhvillimor, KSV/019: Asistencë Teknike në Kontekst të Integritimit Evropian;

Kryetarja tha se Marrëveshja ka të bëjë me projektin e përbashkët zhvillimor të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatit të Madh të Luksemburgut në mbështetje të përpjekjeve të Kosovës për përmbushjen e kërkesave të MSA-së.

E dini qe kjo marrëveshje ka qenë paraprakisht ne komision dhe është diskutuar gjatë me Ministren e Integritimeve Evropiane , dje kemi kërkuar sqarime se pse është vonuar dhe ata kanë vendosur qe pas diskutimeve qe kanë pas me Qeverinë e Luksemburgut ta sjellin prapë për votim ne Komision.

Marrëveshja nuk ka ndryshuar dhe është njëjta me atë qe patëm diskutuar me ministren.

Hapi diskutimin dhe pastaj ftoj anëtarët te deklarohen me votë.

Pas votimit kryetarja konstatoj se komisioni me shumicë votash nxori këtë;

Rekomandim

Miratohet Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes Bilaterale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatit të Madh të Luksemburgut në Kuadër të Projektit të Bashkëpunimit Zhvillimor, KSV/019: Asistencë Teknike në Kontekst të Integritimit Evropian se bashku me amendamentin e propozuar.

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-043 për lirin e asociimit në Organizata Joqeveritare, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Kryetarja lidhur me këtë Projektligj paraqiti opinionin ligjor dhe tha se çështjet e rregulluara dhe adresuara me këtë projektligj, nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së.

Andaj, konstatoj se Projektligji për lirin e asociimit në Organizata Joqeveritare, me amendamentet e Komisionit funksional nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, dhe si i tillë mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.

Hapi diskutimin dhe e hodhi ne votim.

Pas votimit Kryetarja konstatoj se Komisioni me shumicë votash nxori këtë;

Rekomandim

Projektligjit nr. 06/L-043 për lirin e asociimit në Organizata Joqeveritare, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe si i tillë mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.

7. Te ndryshme;

Kryetarja tha se në si Komisioni jemi dakorduar ti kemi disa vizita te Komisionit për te intensifikua fazën e fundit te lobimit për liberalizimin e vizave,. Andaj kërkoj nga administrata ti filloj përgatitjet për realizimin e vizitave te parapara.

Mbledhja përfundoi në orën 11:35.

Përgatitur nga:
Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetare e Komisionit
Blerta Deliu Kodra
